

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GREEN FIELD CONSTRUCTION” SHPK



Ortaku themelues si më poshtë:

- Genti Malko, i biri i Omerit, i datëlindjes 05.07.1973, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H30705147M;

bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 25.01.2021, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

- 1.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “GREEN FIELD CONSTRUCTION”.
- 1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

- 2.1 Shoqëria tregtare “GREEN FIELD CONSTRUCTION” ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “GREEN FIELD CONSTRUCTION” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga “Janosh Hunyadi”, pallati Ana, kati 4, zyra 3, Tiranë.
- 3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:
 - Punime të përgjithshme në ndërtim si më poshtë:
 - punime gërmimi në tokë;
 - ndërtime civile dhe industriale, ndërtim banesash, vilash, pallatesh nën dhe mbi 5 kat;
 - rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada;
 - punime nëntokësore; ura e vepra arti;
 - diga dhe tunele hidroteknike;
 - ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje;
 - punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime;
 - punime të inxhinierisë së mjedisit;
 - rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;
 - ndërtime për nënstacionet, kabinetat e transformatorëve, linja e TN të mesëm dhe të lartë dhe shpërndatje të energjisë, ndërtim i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.
 - Punime speciale ndërtimi, si më poshtë:
 - punime për prishjen e ndërtimeve;
 - punime strukturore speciale;
 - shtresa dhe mbistruktura speciale;
 - impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtje e tyre;


1



- impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues);
 - punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese, ndërtime parafabrikate beton arme, struktura metalike dhe druri;
 - impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut;
 - sinjalistika rrugore jo ndriçuese;
 - barriera dhe mbrojtje rrugore;
 - impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
 - impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni;
 - impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.;
 - ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij;
 - ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane;
 - sistemet kundra zhurmës dhe infrastrukturës.
- Realizimi i veprave publike dhe private, si në vijim:
- ndërtimi dhe mirëmbajtja e strukturave spitalore;
 - punime në struktura detare, portuale dhe lumore;
 - punime rikuperimi dhe restaurimi, konsolidimi dhe mbrojtjeje të territorit;
 - punime në impiantet e furnizimit me gaz metan, gazsjellësish, vajsjellësish, ujësjellësish, impiantesh hidroelektrike, pyjore dhe vepra ujitjeje dhe evakuimi;
 - ndërtimi i impianteve teknologjike në përgjithësi;
 - ndërtimi i impianteve për pastrimin e ujërave të ndotura nga përdorime të mëparshme.
- Prodhimi dhe shitja, qoftë me shumicë, qoftë me pakicë, e konglomerateve të çimentos dhe atyre bituminoze.
- Shfrytëzimi i gurorëve dhe i minierave të çdo lloji.
- Veprimtari autotransporti edhe për llogari të të tretëve.
- Punime topogjeodezike.
- Shpime gjeologo-inxhinierike, shpime puse për ujë, shpime puse për naftë.

4.2 Shoqëria do të mundet të promovojë themelimin ose marrjen qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë jo të drejtpërdrejtë, të pjesëmarrjeve në fitime, të kuotave ose të pjesëmarrjeve në ndërmarrje të tjera, shoqërive, konsorciumeve dhe enteve në përgjithësi, të gjitha këto në mënyrë instrumentale dhe në masë jo mbizotëruese kundrejt veprimtarive të tjera që përbëjnë objektin shoqëror.


4.3 Shoqëria do të mundë, gjithashtu, të kryejë të gjitha veprimtaritë e nevojshme ose të dobishme për përmbushjen e qëllimeve shoqërore, ndër të cilat operacione të paluajtshme, të luajtshme, industriale, tregtare dhe financiare, duke përfshirë këtu edhe dhënien e garancive reale dhe / ose personale, të lëshuara në interesin e shoqërisë për obligacionet qoftë të vetat, qoftë të të tretëve. Të gjitha këto veprimtari duhet të zhvillohen brenda kufijve dhe duke respektuar normat që rregullojnë ushtrimin, si edhe duke respektuar legjislacionin në fushën e veprimtarive që u rezervohen të regjistruarve në Kolegje, Urdhra ose Regjistra profesionale, Në mënyrë të veçantë, veprimtaritë me natyrë financiare duhet të zhvillohen në përputhje me ligjet në fuqi në këtë fushë.

NENI 5 **Kohëzgjatja**

5.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6 **Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

6.1 Shoqëria tregtare "GREEN FIELD CONSTRUCTION" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.



NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortaku/ët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "GREEN FIELD CONSTRUCTION" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "GREEN FIELD CONSTRUCTION" SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku.

8.2 Ortaku Genti Malko zotëron një kuotë të kapitalit me vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind për qind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

9.2 Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë. Shoqëria për efekt të aktivitetit që do të kryejë, do të ketë dhe një drejtues teknik.

NENI 10
Administratori dhe Drejtuesi Teknik

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është z. Genti Malko, i biri i Omerit, i datëlindjes 05.07.1973, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H30705147M.

10.2 Drejtuesi teknik i shoqërisë do të jetë inxhinier ndërtimi. Drejtuesi teknik i shoqërisë do të jetë organ i punësuar në shoqëri, me një kontratë pune minimalisht 3 vjeçare. Drejtues teknik i shoqërisë do të jetë z. Klarent Hadaj, i datëlindjes 09.07.1988, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I80709043T.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortaku/ët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "GREEN FIELD CONSTRUCTION" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore

**ORTAKU THEMELUES
GENTI MALKO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ANILA K. GJERMENI



DATE 26/01/2021
NR-REP 222

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 26.01.2021, para meje Notere ANILA K. GJERMENI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, BLV" Gjergj Fishta", NR.4, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Genti Malko, atësia Omer, amësia Myrvete, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Irfan Tomini; Nd. Pall.18; H. 1; Ap. 31; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 05/07/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034634953 dhe nr. personal H30705147M, .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitë dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Aktin e Themelimit të Shoqerise Tregtare me Përgjegjesi te kufizuar "Green Field Construction"SHPK...", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ANILA K. GJERMENI